



ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

# Buletini

Publikim  
dymujor  
Viti XI  
Nr.66  
Maj - Qershor  
2014

## SDC-ja vazhdon të mbështetë AKK-në edhe në periudhën 2014-2017

Asociacioni i Komunave të Kosovës do të vazhdojë të mbështetet nga Agjensia Zvicrane për Zhvillim (SDC) edhe për katër vitet e ardhshme. Marrëveshja e cila u nënshkrua nga Drejtori Ekzekutiv i AKK-së z.Sazan Ibrahimimi dhe z.Marcus Baehler Drejtor i SDC-së, është për periudhën 2014 -2017. Qëllimi i vazhimit të bashkëpunimit dhe mbështetjes së SDC-së për Asociacionin e Komunave të Kosovës konsiston në përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të komunave përmes lobimit dhe avokimit, ofrimit të shërbimeve më të avancuara dhe përmirësimin e performancës së komunave, koordinimin dhe bashkë-punimin me partnerët e qeverisjes lokale, fuqizimin e mëtejshëm të AKK-së në komunikim me komunitetin dhe dinamizimin e vazhdimin dhe rritjen e performancës funksionale nga administrata e AKK-së.



**Komunitetet mbështesin Peticionin  
“Kërkojmë Drejtësi Ndërkombëtare  
për Gratë e Dhunuara gjatë Luftës së  
fundit në Kosovë”**



**Konferenca përmbyllëse e Projektit  
“Të Punojmë së bashku për Zhvillim”**

**Kryesuesit e Kuvendeve të  
Komunave kërkojnë rritjen e  
mëditjeve për këshilltarët komunal**

Kryesuesja e Kolegjiut të Kryesuesve të Kuvendeve të Komunave znj.Valentina Bunjaku-Rexhepi, në emër të të gjithë anëtarëve të Kuvendeve të Komunave ka kërkuar rritjen e mëditjes së këshilltarëve komunalë në nivel të Kosovës, me arsyetimin se rritja prej 25 për qind e pagave duhet të vlejë edhe për kuvendarët. “Është shumë e arsyeshme rritja e mëditjes, sepse nëse e duam një Kuvend të Komunës më efektiv duhet të stimulohen edhe këshilltarët komunal sikur kategoritë tjera” – ka thënë zonja Bunjaku-Rexhepi.



**Mbahet Akademia për Eficiencën e Energjisë**

## SDC vazhdon të mbështetë AKK-në edhe në periudhën 2014-2017

Asociacioni i Komunave të Kosovës do të vazhdojë të mbështetet nga Agjencia Zvicrane për Zhvillim (SDC) edhe për katër vitet e ardhshme. Marrëveshja e cila u nënshkrua nga Drejtori Ekzekutiv i AKK-së z.Sazan Ibrahim i dhe z.Marcus Baehler Drejtor i SDC-së, është për periudhën 2014 -2017.

Qëllimi i vazhimit të bashkëpunimit dhe mbështetjes së SDC-së për Asociacionin e Komunave të Kosovës konsiston në përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të komunave përmes lobimit dhe avokimit, ofrimit të shërbimeve më të avancuara dhe përmirësimin e performancës së komunave, koordinimin dhe bashkëpunimin me partnerët e qeveris-



jes lokale, fuqizimin e mëtejshëm të AKK-së në komunikim me komunitetin si dhe dinamizimin e vazhimit dhe rritjen e performancës funksionale nga administrata e AKK-së.

Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje e cila është vazhdim i bashkëpunimit dhe mbështetjes

së SDC-së për AKK-në edhe në periudhën 2014-2017 është vlerësim i angazhimeve dhe performancës së AKK-së deri më tani si dhe synim i objektiv që përmes Asociacionit të Komunës të vazhdohet të llohet për interesat e pushtetit lokal në Kosovë.

## Komunat mbështesin Peticionin “Kërkojmë Drejtësi Ndërkombëtare për Gratë e Dhunuara gjatë Luftës së fundit në Kosovë”



Kryetarët e komunave dhe përfaqësuesit e Zyrrave Komunale për Barazi Gjinore kanë marrë pjesë në takimimin e organizuar nga Zyra e Zëvendëskryeministrës së Qeverisë së Republikës së Kosovës znj.Edita Tahiri lidhur me informimin rreth iniciativës për organizimin e Peticionit “Kërkojmë Drejtësi Ndërkombëtare për Gratë e Dhunuara gjatë Luftës së fundit në Kosovë” dhe

nevojën e përkrahjes së kësaj iniciative nga ana e komunave. Ky peticion do t'i drejtohet OKB-së me kërkesat konkrete për vendosjen e drejtësisë për çështjen e Grave të dhunuara gjatë luftës në Kosovë si dhe që përgjegjësitë e krimeve të tilla të përballen me drejtësinë ndërkombëtare. Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij peticioni dhe nevojën që të jetë sa më masovike mbështetja nga qytetarët e vendit tonë, konsiderojmë se me një angazhim të përbashkët do të mund t'ia arrijmë qëllimit tonë, përkatësisht të realizojmë sa më me sukses këtë peticioni. Në këtë takim u zotua se si kryetar të Komunave të Republikës së Kosovës do të bashkangjitemi kësaj iniciative e cila udhëhiqet nga përfaqësuesit e partive politike dhe institucioneve relevante në Kosovë.

Në të njëjtën kohë kërkojmë që Zyrat Komunale për Barazi Gjinore të marrin mbështetjen Tuaj të plotë në këtë proces me rëndësi nacionale.

# Takimi i Kolegjiut të Zyrtarëve Ligjor të Komunave të Republikës së Kosovës

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) organizoi takimin e dytë të Kolegjiut të Zyrtarëve Ligjor të Komunave të Republikës së Kosovës të AKK-së, për vitin 2014. Qëllimi i takimit ishte, zbatimi i planit të punës për pikat që janë paraparë, pastaj njoftimi lidhur me dokumentin e hartuar nga kryesia e kolegjiut, bashkëpunimi me Kolegjiun e Shërbimeve Publike për hartimin e Rregullores për menaxhimin e mbeturinave si dhe çështje tjera, për të cilat janë të interesuar të diskutojnë zyrtarët ligjor të komunave.

Në këtë takim morën pjesë zyrtarët ligjor të Komunave, dy përfaqësues nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal znj. Flutura Hoxha dhe z. Besim Myrtezani, Koordinatorin nga GIZ-i z. Driton Vatovci, zyrtari ligjor nga OSBE-ja z. Arben Fetahu si dhe zyrtarët e AKK-së.

Kryesuesi i KZL-së Hevzi Matoshi hapi takimin i përshëndeti të pranishmit, dhe prezantoi rendin e ditës për këtë takim. Ndërsa znj. Shqipe Arifaj – në emër të AKK-së, i falënderojë pjesëmarrësit për takimin, po ashtu i njoftoj shkurtimisht për aktivitetet e AKK-së për këtë periudhë gjashtë mujore si dhe i falënderojë OSBE-në për përkrahje dhe MAPL-në për bashkëpunim me këtë Kolegjiun.

Përfaqësuesi i OSBE-së Arben Fetahu tha se OSBE-ja vazhdimisht do të gjejë mundësitë për të ju përkrahur Kolegjiun e juaj pasi konsideron se jeni kolegjiun që keni përgjegjësi nëpër komuna dhe jeni kolegjiun që keni treguar përkushtim në punë dhe keni treguar mjaft suksese.

## Diskutim rreth Udhëzuesit – Procedurat për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale

Kryesuesi shpjegoi hapat në të cilat ka kaluar kryesia deri sa ka hartuar këtë dokument pasi që ishte nevojë dhe kërkesë e zyrtarëve komunal për ta pasur një doracak i cili do të jepte



shpjegime më të qarta dhe do të ju lehtësonte atyre punën nëpër komuna.

Ky dokument u vlerësua si shumë i nevojshëm për komunat dhe kërkuan që ky dokument të botohet dhe të ju shpërndahet të gjitha komunave e ku kërkuan përkrahje nga OSBE-ja për botimin e Doracakut.

Zyrtarët Ligjor diskutuan dhe të gjitha dhanë mendimet e tyre, disa i qiten në pah disa sfida pasi që ligji ka lënë disa zbrazëtira juridike, disa i treguan praktikrat e tyre si kanë vepruar nëpër komuna, po ashtu njëzëri u pajtuan që ky dokument ishte shumë i nevojshëm për ta.

Besim Myrtezani - MAPL - paraqiti disa opinione rreth procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, pastaj tregoi për punën e grupit punues për hartimin e ligjit, pastaj hartimin e rregullores dhe përshëndeti punën që e kanë bërë kryesia e KZL-së për hartimin e Doracakut.

## Ligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje (obligimet e komunave / aktivitetet që duhet ndërmerren)

Kryesuesi paraqiti disa shqetësime të zyrtarëve të komunale pasi që ende nuk janë nxjerrë aktet nënligjore nga MMPH-ja, të cilat akte do të mundësonin zbatimin e këtij ligji dhe do të ishin procedurat më të qarta. Zyrtarët Ligjor kërkuan që me shkresë të veçantë AKK-ja t'i drejtohet zyrtarëve të MMPH-së dhe të

kërkojë nga ata që aktet nënligjore që janë të parapara me ligj duhet të nxirren sa më shpejt për arsye se janë të domosdoshme për zbatimin e Ligjit për Trajtimin e Ndërtimeve pa leje.

## Diskutim rreth bashkëpunimit me Kolegjiun e Shërbimeve Publike - hartimi i Rregullores për menaxhim të mbeturinave

Kolegjiun i Zyrtarëve Ligjor është i gatshëm për bashkëpunim me Kolegjiun e Shërbimeve Publike, për ta formuar një grup punues të përbashkët për hartimin e model rregullores për menaxhimin e mbeturinave, e cila do të ju shpërndahet të gjitha komunave si model, e më pastaj grupi punues i secilës komunë duhet ta kompletojë atë rregullore sipas specifikave të komunës së vet. Po ashtu kërkuan përkrahje edhe nga GIZ-i për organizimin e ndonjë punëtorie e cila do të ishte mënyra më e mirë për të patur sukses, që grupi punues të ketë kushte të mira për të punuar.

Driton Vatovci-GIZ tha se GIZ-i do ta përkrah sipas mundësive kërkesën e Kolegjiut për organizimin e një punëtorie për hartimin e model rregullores për menaxhimin e mbeturinave edhe pse theksoj se paraprakisht duhet hartuar planet menaxhuese nëpër komuna e më pastaj duhet të hartohet rregullorja, sepse këto janë dy obligimet ligjore sipas ligjit të mbeturinave që kanë komunat.

## Kryesuesit e Kuvendeve të Komunave kërkojnë rritjen e mëditjeve për këshilltarët komunal



Kolegjiumi i Kryesuesve të Kuvendeve Komunale ka kërkuar rritjen e mëditjeve për anëtarët e Kuvendeve të Komunave. Ky propozim është paraqitur edhe në mbledhjen e Kolegjiumit të Kryesuesve të Kuvendeve të Komunave të Republikës së Kosovës, e ku kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe OSBE-ja. Kryesuesja e Kolegjiumit të Kryesuesve të Kuvendeve të Komunave znj.Valentina Bunjaku-Rexhepi, në emër të të gjithë anëtarëve të

Kuvendeve të Komunave ka kërkuar rritjen e mëditjes së këshilltarëve komunalë në nivel të Kosovës, me arsyetimin se rritja prej 25 për qind e pagave duhet të vlejë edhe për kuvendarët. “Është shumë e arsyeshme rritja e mëditjes, sepse nëse e duam një Kuvend të Komunës më efektiv duhet të stimulohen edhe këshilltarët komunal sikur kategoritë tjera” – ka thënë zonja Bunjaku-Rexhepi.

## Konferenca Përmbyllëse e Projektit “Të Punojmë së bashku për Zhvillim”

Me 5 Qershor 2014 në Këshillin e Evropës në Strasburg, Zyrtarja e AKK-së mori pjesë në Konferencën Përmbyllëse të Projektit “Të Punojmë së bashku për Zhvillim”, organizuar nga Asociacioni i Agjencive të Demokracisë Lokale së bashku me partnerët e projektit dhe bashkëpunëtorët. Konferenca ishte ngjarja përfundimtare e projektit shumëvjeçar për zhvillim financiar nga BE- ja e koordinuar nga ALDA dhe që ka përfshirë më shumë se 20 partnerë dhe bashkëpunëtorë nga Evropa, ndërsa AKK-ja ishte e përfshirë si një bashkëpunëtor. I gjithë projekti ka trajtuar çështje të zhvillimit, forcimin e kapaciteteve të përfaqësuesve të Autoriteteve Lokale dhe



Organizatave të Shoqërisë Civile për të vepruar si agjentë të zhvillimit brenda dhe jashtë kufijve të BE-së. Më tutje, në 6 qershor 2014 u mbajt edhe Kuvendi i Përgjithshëm i ALDA-së dhe këto dokumente janë miratuar: Procesverbal i Fundit nga Kuvendi i Përgjithshëm, Rregullorja e Kuvendit, Miratimi i Raportit të Financave dhe Thesarit 2013, Prezantimi i Programit dhe Buxhetit të vitit 2014, Prezantimi Strategjisë për 2013-2016 ku u pasua nga votimi për ndryshimet e Statutit. Asociacioni i Komunave të Kosovës është anëtar i Asociacionit së Agjencive për Demokraci Lokale (ALDA).

## Mbahet Akademia për Eficiencën e Energjisë

Asociacioni i Komunave të Kosovës në bashkëpunim me Konrad Adenauer Stiftung (KAS), Bankën Gjermane (KFW), Shoqatën për Energji të Ripërtrishme (SHERK) dhe Asociacionin Kosovar për Energji të Ripërtrishme dhe Energji Efiqiente (AKEREE) ka organizuar Akademi për Eficiencën e Energjisë me temën: Zhvillimi i Eficiencës së Energjisë dhe burimeve të Ripërtrishme të Energjisë në nivelin lokal në Kosovë. Në këtë Akademi ku kanë prezantuar ekspertë për efiqencë të energjisë nga vendi dhe rajoni kanë marrë pjesë zyrtarët për energji të komunave dhe zyrtarë tjerë të drejtorive për shërbime publike të komunave. Qëllimi i organizimit të Akademisë ishte prezantimi për zyrtarët e komunave komunal të koncepteve të eficiencës së energjisë, planeve të zhvillimit të qëndrueshëm të energjisë si dhe janë diskutuar mundësitë për implementimin e këtyre masave për të mundësuar përdorimin e burimeve alternative të energjisë si elemente kyçe për ruajtjen e energjisë dhe për zhvillim ekonomik të komunave.

## Lajme nga Komunat

### Për Prishtinën digjitale

Nisma e përbashkët në mes të Komunës së Prishtinës, Innovation Centre Kosovo dhe UNDP-së “Për Prishtinën digjitale”, ka mbledhur shumë të rinj me shumë ide kreative për aplikacione të ndryshme mobile dhe ueb.



Sfida "Për Prishtinën Digjitale" i pati dy fitues me shpërblim financiar në vlerë prej 4,000 euro secilit, mbështetje dhe ekspertizë për zhvillimin e aplikacionit, mundësi inkubimi në ICK, si dhe rrjetizim me donatorë dhe partnerë të mundshëm. Shpërblimet, kategoria “Transparenca në punësim” – Ekipi “On Focus” dhe kategoria “Transparenca në shpenzime” – Ekipi “Mikrobiz” u ndanë nga Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës të Prishtinës, Steliana Nedera, Zv.Përfaqësuese e Përhershme e UNDP-së, dhe nga Uranik Begu, Drejtor Ekzekutiv i Innovation Center Kosove. Aplikacionet fituese do të vendosen në uebfaqen që shfrytëzohet nga Komuna e Prishtinës si dhe do të kalojnë një periudhë dy mujore të inkubacionit për t’u zhvilluar në aplikacione të plota.

### Prishtina lexon

Qëllimi i kësaj kampanje ishte që përmes aktiviteteve edukative dhe argëtuese të nxisë dëshirën për lexim tek fëmijët. Me këtë rast u organizuan disa kënde të leximit dhe të aktiviteteve, ku lexuan nxënës nga të gjitha shkollat, si dhe shumë personalitete të njohura për publikun, si nga politika, ashtu edhe nga mediat e arti. Përveç këndeve të leximit, organizatat si Down Syndrome Kosova, SOS Kinderdorf, Handikos, World Vision International, Terre des Hommes, The Ideas and Partnership, Amici dei Bambini, Save the Children, institucioni i Avokatit të Popullit dhe Posta e Kosovës, organizuan aktivitete të ndryshme që kanë për qëllim promovimin e leximit. Po ashtu, Aleanca Franceze dhe Këndi Amerikan promovuan leximin në gjuhën frënge dhe në atë angleze. Në sheshin kryesor të qytetit, përveç tendës informuese, kishim edhe tendën bibliotekë, tendën e shkrimtarëve të rinj, këndin “Dhuro një libër” si dhe këndin e fotografisë.



Për ta organizuar këtë kampanjë, Komuna e Prishtinës kishte ftuar aktorët, organizatat joqeveritare, shkollat publike dhe private, çerdhet publike, Teatrin “Dodona” dhe Bibliotekën e qytetit, që përmes aktiviteteve të përbashkëta ta promovojmë leximin tek fëmijët.

## Shkurtimisht

- AKK-ja, e ka shqyrtuar “Projektligjin për Siguri në Komunikacion” me mekanizmat e saj dhe komentet i ka dërguar në Ministrinë e Infrastrukturës-Departamentin e Automjeteve, pritet që ministria të merr parasysh rekomandimet e AKK-së.

- AKK-ja ka pranuar kërkesën e Kolegjiut të Zyrtarëve Ligjor, të cilën kërkesë e kemi dërguar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal-Departamentin Ligjor, për ndryshimin e “Rregullores 01/2013 për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve komunale”, po ashtu kolegjiut ka hartuar një projekt rregullorë të re, si alternativë që ministria përkatëse mund ta ketë ndihmesë për grupin punues.

- AKK-ja emëroi tre përfaqësues për “Komisionin për mirëqenie, përfshirje sociale dhe decentralizim”, në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtorin Ekzekutiv të AKK-së, Kryesuesin e Kolegjiut të drejtorëve për Buxhet dhe Financa dhe Kryesuesen e Kolegjiut për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

- Drejtori Ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës Z. Sazan Ibrahim ka qenë i ftuar të marrë pjesë në Takimin e 7-të Këshillit Kombëtar Kundër Korrupsionit. Këshilli kryesohet nga presidentja e Kosovës Zonja Atifete Jahjaga dhe temat e takimit ishin zgjedhjet qendrore të 8 qershor 2014 dhe korrupsion.

## Lajme nga Komunat

### Shërbime online për dokumente edhe në komunën e Shtimes

Përmes marrëveshjes së arritur sot mes Postës së Kosovës dhe Komunës së Shtimes të gjithë qytetarët e kësaj komune do të mund të aplikojnë online për dokumente personale të cilat pastaj do t'u dërgohen në shtëpi përmes postierëve. Përmes marrëveshjes së arritur sot mes Postës së Kosovës dhe Komunës së Shtimes të gjithë qytetarët e kësaj komune do të mund të aplikojnë online për dokumente personale të cilat pastaj do t'u dërgohen në shtëpi përmes postierëve.

Kryetari i Komunës z., Naim Ismajli dhe Kryeshefi Ekzekutiv i Postës, z.Sejdi Hoxha janë shprehur të kënaqur që ky projekt shumë i dobishëm për qytetarët do të zbatohet edhe në komunën e Shtimes.

Kryetari i komunës, z. Ismajli tha se përmes mundësisë së aplikimit online për dokumente personale, Komuna e Shtimes ndihmon edhe mërgimtarët e kësaj komune.

"Megjithëse ne kemi arritur që të ofrojmë shërbimin më efikas të mundshëm për qytetarët tanë sa i përket certifikatave të gjendjes civile, mundësia që dokumentet të merren edhe pa ardhur fare në zyrat tona tregon përkushtimin tonë për shërbime sa më cilësore për qytetarët e Shtimes", ka thënë veç tjerash kryetari z. NaimIsmajli.

Ai, gjithashtu ka theksuar se deri më tash Komuna e Shtimes është e vetmja komunë në Kosovë që ka zbatuar tërësisht projektin e sistemit të adresave. Përveç emërtimit të rrugëve, çdo shtëpi në këtë komunë e ka adresën e vet, që paraqet një lehtësi të madhe edhe për postierët e Postës së Kosovës.

Kryetari, i cili është edhe Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës u ka bërë thirrje të gjitha kryetarëve të komunave të Republikës së Kosovës që të angazhohen maksimalisht në mënyrë që qytetarëve të tyre t'u ofrojnë shërbimin online për dokumente personale.

Kryeshefi Ekzekutiv i Postës së Kosovës, z. Sejdi Hoxha, me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes ka thënë: "Jam shumë i kënaqur që pas marrëveshjeve me Komunën e Gjilanit dhe të Prishtinës këtë shërbim jashtëzakonisht të rëndësishëm për qytetarët e kemi arritur edhe me Komunën e Shtimes. Në këtë mënyrë edhe Komuna edhe Posta e Kosovës po realizojnë objektivat për shërbime të standardeve evropiane për qytetarët",

Këtë marrëveshje e ka vlerësuar lartë edhe Kryetari i Bordit të Drejtorëve të Postës,z. Halit Isufi. Ndërsa, kryeshefi Hoxha ka theksuar se Posta e Kosovës është e gatshme t'u përgjigjet në çdo kohë kërkesave të të gjitha komunave për zbatimin e këtij projekti.

### Komuna e Gjakovës nënshkruan memorandumin me UNICEF-in për implementimin e projektit "Gjakova për fëmijët"

Gjakova është e para në vend që po implementon pilot projektin e këtij lloji. "Ky projekt është një thirrje gjithëpërfshirëse dhe përgjegjshmëri për realizimin progresiv të drejtave të fëmijëve. Në praktikë kjo do të thotë se të drejtat e fëmijëve pasqyrohen në politikat zhvillimore komunale, në rregullore, programet dhe buxhetet komunale", ka thënë kryetarja Mimoza Kusari-Lila. Kryetarja e Komunës së Gjakovës Mimoza Kusari-Lila dhe Lajla Omarga, shefe e zyrës së UNICEF-it në Kosovë, kanë nënshkruara memorandumin e mirëkuptimit për implementimin e përbashkët të projektit "Gjakova për fëmijët", gjatë periudhës qershor-dhjetor-2014, si pjesë përbërëse e politikës komunale për zhvillim njerëzor të barabartë. Pas procedurës së nënshkrimit të këtij memorandum që është një interes me vlerë për fëmijë e komunës së Gjakovës, është konstatuar se "Projekti "Gjakova për Fëmijë", është një thirrje për veprim dhe angazhim që çështja e e fëmijëve të përfshihen në agjendën e politikave të qeverisjes komunale. "Gjakova është e para në vend që po implementon pilot projektin e këtij lloji", ka thënë kryetarja Mimoza Kusari-Lila. "Ky projekt është një thirrje gjithëpërfshirëse dhe përgjegjshmëri për realizimin progresiv të drejtave të fëmijëve. Në praktikë kjo do të thotë se të drejtat e fëmijëve pasqyrohen në politikat zhvillimore komunale, në rregullore, programet dhe buxhetet komunale", ka thënë kryetarja Mimoza Kusari-Lila, për të shtuar në vazhdim se qeveria lokale e Gjakovës do ta ketë prioritet ngritjen e standardit jetësorë të fëmijëve, më konkretisht zhvillimi i tyre në të gjitha aspektet te jetë në nivele të lartë bashkëkohor në trend të shteteve zhvillimore evropiane. Në anën tjetër shefja e zyrës së UNICEF-it në Kosovë Lajla Omarga, ka theksuar se sotë me kryetaren e komunës Kusari-Lila e kemi arritur qëllimin, pra nënshkrimin e memorandumit, që ka të bëjë me krijimin e një komune që vazhdon në procesin e ndryshimeve të sistemit lidhur me adresimin e çështjeve të barazisë, sjelljes në kërkim të shëndetit dhe zhvillimit njerëzor dhe drejtësisë sociale. Lajla Omarga, ka thënë se qëllimi është që premtimet të kthehen në realizim për fëmijët duke u fokusuar në dy prioritete programore të intervenimit. Së pari nxitja e përgjeshmerisë, planifikimit, koordinimit dhe monitorimit të shtuar në sistemin qeverisës komunal. Dhe sipas saj qëllimi I dytë është krijimi i një komune gjithëpërfshirëse, me intervenime të mbështetur të UNICEF-I dhe rezultatet e pritura në zhvillimin e femërisë së hershme, braktisjen e shkollave, mortalitetin perinatal, mbrojtjen e fëmijëve, dhunën në baza gjinore, fuqizimin, pjesëmarrjen dhe inovacionin e të rinjve në nivel komunal", ka thënë Omarga.

## BE edhe në të ardhmen do ta ndihmojë regjionin e Anamoravës

Agjencia për Zhvillim Rajonal – Lindje ka mbajtur një takim, në të cilin kanë marrë pjesë zyrtarë të lartë të zyrës së Bashkimit Europian në Kosovë, nënkryetari i Komunës së Gjilanit Rexhep Kadriu, kryetari i Kamenicës Begzad Sinani. Bashkimi Europian ka ndihmuar Gjilanin dhe Anamoravën në ndërtim të shkollave, bibliotekës dhe ndihmë bizneseve të vogla dhe të mesme. Christof Stock, shef i bashkëpunimit në zyrën e BE-së në Kosovë, theksoi se rajoni i lindjes ka fituar më së shumti projekte në programin “Kosova e Bukur”, ndërsa u zotua se edhe në të ardhmen ky regjion do të ketë përfitime nga fondet e BE-së.

Ndërsa nënkryetari Rexhep Kadriu ka falënderuar BE-në për ndihmën e madhe për Gjilanin, duke thënë se këto projekte ua kanë bërë jetën më të mirë qytetarëve. “Në emër të kryetarit Haziri ju falënderoj shumë për ardhjen në Gjilan. Pa ndihmën tuaj dhe RDA-së, nuk do të mund të bëheshin këto projekte të mira. Faleminderit Bashkimit Europian, që përmes programit të EURED’it kanë bërë projekte të mira në vitet e kaluara për ndërtimin e shkollave, bibliotekës etj, e tash së fundi edhe projektet e fituara nga “Kosova e Bukur”, të cilat kanë për qëllim t’ua bëjnë jetën më të mirë qytetarëve. Ndihamë e BE-së për Gjilanin nuk është vetëm në ndërtim të objekteve, por edhe në ndihmën që u është ofruar bizneseve të vogla dhe të mesme dhe me këtë mbështetje është forcuar ekonomia gjilanase”, ka thënë nënkryetari Kadriu.

Ndërsa kryesuesi i Bordit AZHR lindje kryetari i Kamenicës Begzad Sinani, ka çmuar angazhimet e BE për të ndihmuar regjionin e lindjes, duke thënë se pa këtë ndihmë as do të mund të imagjinohej zhvillimi i kësaj pjese. “Si kryesues i Bordit AZHR lindje, ju falënderoj për bashkëpunimin e deritashëm. Respektoj zgjedhjen që keni ardhur për vizitën që të informoheni për të arriturat e kësaj ane me vullnetin që të bëhen punë të mira. I çmoj shumë angazhimet tuaja,

## Lajme nga Komunitat

presim shumë nga ju, kemi nevojë për ju dhe me ndihmën tuaj synojmë t’i arrijmë standardet dhe jemi gati të dëgjojmë këshillat dhe rekomandimet tuaja”, ka pohuar kryetari i Kamenicës Begzad Sinani.

## Podujeva dhe Kriva Pallanka konkurrojnë me projekte të përbashkëta në Komisionin Evropian

Nënkryetari i Komunës së Podujevës, z.Agim Kikaj dhe drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, z.Avni Fetahu, kanë pritur në një takim Kryetarin e Komunës së Kriva Pallankës së Maqedonisë, z. Arsenço Aleksovski dhe drejtorin e Zhvillimit dhe Planifikimit Fushko Arsovski.

Gjatë takimit të nënkryetarit të Komunës së Podujevës, z.Agim Kikaj me kryetarin e Komunës së Kriva Pallankës z.Arsenço Aleksovski është diskutuar për projektin e përbashkët “Together for better Life” me të cilin Komuna e Podujevës dhe Kriva Pallankës kanë aplikuar në CBC Cross – Border Cooperation në kuadër të Komisionit Evropian. Palët u dakorduan që të intensifikojnë angazhimet e përbashkëta për lobim në mënyrë që projekti i përbashkët të pranohet.

Qëllimi kryesor i projektit është zhvillimi ekonomik-social, përmes ngritjes së infrastrukturës në sektorin e mbrojtjes së ambientit dhe ruajtjes së resurseve humane. Komuna e Podujevës nga ky projekt do të përfitojë ndërtimin e kolektorit në Liqenin e Batllavës në gjatësi 4,2 km. Komuna e Kriva Pallankës është aplikuesi i parë, ndërsa Komuna e Podujevës aplikuesi i dytë. Ky projekt ka koston 484,323,00 euro, ndërsa shuma e kërkuar nga Komisioni Evropian është 411,674,75 euro. Nënkryetari i Komunës së Podujevës, z.Kikaj dhe kryetari i Kriva Pallankës z.Aleksovski u akorduan që të vazhdojnë bashkëpunimin edhe në shumë sfera të tjera.

## Shkurtimisht

- Është mbajtur takimi i Kolegjiumit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, dhe është aprovuar Plani vjetor i Punës së Kolegjiumit për vitin 2014 i cili është i bazuar në Strategjinë e Kolegjiumit 2014-2016. Në këtë takim morën pjesë antarët e Kolegjiumit si dhe përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies, ku është planifikuar të punohet më shumë në këto fusha si Strehimi Familjar, Eliminimi i Punës së Fëmijëve, Mbështetja e fëmijëve dhe grave si kategori e dhunës në familje; si dhe Mbështetja dhe përmirësimi i shërbimeve në Qendra të Mjekësisë familjare dhe Qendra për Punë Sociale.

- AKK-ja, e ka shqyrtuar “Projekt Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale 2015-2025” me mekanizmat e saj, dhe komentet i ka përcjellur në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

- Seksioni i Qeverisjes Lokale në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal ka organizuar një tryezë të rrumbullakët me kryesuesit e Kuvendeve Komunale për rolin mbikëqyrës të organeve legjislative, si pjesë e "Fuqizimi i mbikëqyrës komunal, transparencës dhe qasjes në Kosovë". Tryeza e rrumbullakët ka shërbyer si një vend për diskutimin e çështjeve të tilla si, roli mbikëqyrës mbi ekzekutivin gjatë hartimit dhe zbatimin e politikave komunale, përgatitjen e buxhetit komunal dhe të ekzekutimit, si dhe për rëndësinë e raporteve të auditimit.

- Që nga marsi 2009 deri deri në tetor 2013, Misioni i OSBE-së në Kosovë (OSBE) ka monitoruar përmbushjen e takimeve të rregullta të KK-së në 34 komuna. Mbikëqyrja e vlerëson përputhshmërinë komunale me dispozitat ligjore dhe parimeve të qeverisjes së mirë gjatë periudhës legjislative të vitit 2009 - 2013. Gjatë kësaj periudhe, monitori është fokusuar në aspekte të ndryshme të zhvillimit të mbledhjeve të KK-ve, të tilla si njoftimi i mbledhjeve të KK-ve, përfshirjen e publikut dhe pjesëmarrjen e publikut në mbledhjet e KK-ve, parandalimin e konfliktit të interesit, si dhe pajtueshmërinë me standardet gjuhësore. Ajo nxjerr në pah trendet dhe fushat ku është shënuar progresi si dhe zonat ku ka vend për përmirësim, ju referohet komunave që kanë krijuar rastet e praktikave të mira, si dhe ato që kanë dështuar vazhdimisht për të përmbushur dispozitat e caktuara ligjore. Ky dokument mund të gjenden në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe.

- Kolegjiumi për Arsim i AKK-së, respektivisht 10 DKA të përfaqësuar edhe nga zyrtarët arsimor nga komunat Prizren, Fushë Kosovë, Klinë, Graçanicë, Kaçanik, Skenderaj, Pejë, Podujevë,

Gjilan dhe Prishtinë, vazhdoj sesionin trajnues mbi procedurat e punësimit të zyrtarëve komunal dhe personelit profesional në shkolla. Qëllimi i kësaj shkolle (sesioni) kishte për synim njohjen më të mirë të DKA-ve dhe personelit tjetër me procedurat e punësimit në Kosovë, si dhe përfitimin e njohurive të reja të prezentuara nga trajnues nga Britania e Madhe dhe trajner vendor. Trajnimi dyditor ishte pjesë e Programi trajnues Strategjia e Komunikimit "Talk On".

- Kolegjiumi për Arsim i AKK-së organizoi takimin e dytë të Kolegjiumit të Arsimit më 27 Maj, 2014. ku u shqyrtua dhe miratua plani i punës për vitin 2014, i bazuar në Planin Strategjik për Kolegjiumin e Arsimit 2013-2016. Pjesëmarrës në takimin e Kolegjiumit të Arsimit ishin drejtorët komunal të arsimit, përfaqësues nga MASHT, Programi GIZ, Programi USAID BEP, dhe IKAP. DKA-të u njoftuan nga MASHT për ecurinë organizimit të procesit të Testit të Maturës dhe atij të arritshmërisë, ku u vlerësua puna dhe angazhimi i administratoreve dhe zyrtareve komunal dhe DKA-të u njoftuan se ne te ardhmen pritet që ky proces të avancohet dhe të organizohet plotësisht nga vete komunat. Para DKA-ve e prezantua veç tjerash edhe modeli evropian për vlerësimin e performancës, Korniza e Përbashkët Vlerësuese (CAF) nga Instituti Kosovar për Administratë Publike si një mjet për avancimin e performances dhe arritjen e rezultateve edhe me të larta në punë. Drejtorët komunal të arsimit në diskutimet e tyre ngritën çështjen e rregullimit të koeficientit unik për mënyrën e gradimit të punonjësve të arsimit, përshtatjen e formulës së financimit, shkallëzimin pagave sipas vlerësimit me kritere dhe matje të performancës, si dhe çështjen e pensionimit të punonjësve arsimor.

ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

## BULETINI

Viti XI. Nr. 66 • Maj - Qershor 2014

PËRGATITI:

Arsim Osmani - MENAXHER PËR KOMUNIKIM

Tel: 038 245-734; Fax: 038 245-733

E-mail: [info@komunat-ks.net](mailto:info@komunat-ks.net)

Web: [www.komunat-ks.net](http://www.komunat-ks.net)

AKK-ja ka statusin e vëzhguesit në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale në Evropë të Këshillit të Evropës. Është Anëtar i Përhershëm i NALAS-it (Rrjeta e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës JugLindore), anëtar i Rrjetit LOGIN, anëtar i Rrjetit LOGON. Anëtar në pozitën Asociacion i Ftuar (i ngjashëm me pozitën e anëtarit vëzhgues) në Komitetin Evropian të Komunave dhe Regjioneve (CEMR) si dhe anëtar në ALDA (Asociacioni i Agjensive për Demokraci Lokale).

